

Raportet e Shtetit mbi terrorizmin për vitin 2018 KOSOVË

Përmbledhje: Kosova vazhdoi ta luftojë kërcënimin e terrorizmit përmes bashkëpunimit të ngushtë me Shtetet e Bashkuara. Kosova është anëtare e Koalicionit Global për mposhtjen e ISIS-it. Dihet që më shumë se 400 burra, gra dhe fëmijë kosovarë kanë udhëtuar në Siri dhe Irak për t'iu bashkuar grupeve terroriste, prej të cilëve, afro 70 tani janë të vdekur. Rreth 130 persona janë kthyer në Kosovë, ndërsa rreth 200 të tjerë janë në zonën e konfliktit. Në vitin 2018, Qeveria e Kosovës vazhdoi ta zbatojë strategjinë e saj gjithëpërfshirëse të CVE-së (luftimi i ekstremizmit të dhunshëm) dhe azhurnoi planin e saj të veprimit. Në vitin 2018, Qeveria miratoi strategjinë e saj të tretë kundër terrorizmit dhe planin e veprimit për vitin 2018-22.

Siguria dhe situata politike në veri të Kosovës vazhduan ta kufizonin mundësinë e qeverisë për ta ushtruar autoritetin e saj në atë pjesë, ndonëse qeveria me sukses i integroi gjyqtarët, prokurorët dhe stafin serb në institucionet gjyqësore të Kosovës në tetor të vitit 2017, duke shtrirë autoritetin gjyqësor të vendit dhe qasjen në drejtësi për qytetarë. Forca e NATO-s në Kosovë dhe Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit vazhduan të punonin me Policinë e Kosovës (PK) për ta mbajtur një mjedis të qetë e të sigurt dhe për ta forcuar sundimin e ligjit, përfshirë atë në kufij.

Incidentet terroriste të vitit 2018: Nuk u raportua për incidente terroriste në Kosovë në vitin 2018.

Legjislacioni, zbatimi i ligjit dhe siguria kufitare: Korniza legjislative e Kosovës mjafton për t'i ndjekur penalisht individët të cilët dyshohen se kanë kryer ose mbështesin aktivitete terroriste, por ka sfida në zbatimin e saj. Zyrtarët e Kosovës pranojnë nevojën për ta përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet agjencive.

Më 23 nëntor, Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet në kodin penal, që përshijnë një sërë ndryshimesh për ta ndihmuar luftën kundër terrorizmit dhe për t'i zbatuar konventat dhe protokollet e fundit rajonale, përfshirë Konventën e Këshillit të Evropës të vitit 2017 mbi parandalimin e terrorizmit dhe Direktivën e BE-së për luftimin e terrorizmit. Këto ndryshime përfshijnë të gjitha aspektet e financimit të terrorizmit, përfshirë konceptin e krypto-valutave brenda përkufizimit të ndryshuar të fondeve, pasi ato përfaqësojnë vlerë digjitale. Kosova prezantoi dy ligje të reja për t'u marrë me terroristët që vjedhin ose përdorin identitetin e një personi tjetër ose përdorin informacionin e llogarisë së një personi tjetër, dhe terroristët që udhëtojnë në Kosovë ose jashtë Kosovës për aktivitete terroriste. Kjo do t'i lejojë Kosovës t'i ndjekë penalisht terroristët që e përdorin Kosovën si pikë transiti dhe t'u ndihmojë vendeve të huaja në ndjekjen e terroristëve.

Qeveria e Kosovës forcoi dispozitat e saj ekzistuese kundër terrorizmit dhe miratoi një strategji të re kundër terrorizmit për vitin 2018-22. Kjo strategji e re kundër terrorizmit ofron një qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit dhe është një nga prioritetet strategjike të qeverisë. Më 30 mars, Kuvendi miratoi Ligjin për infrastrukturën kritike, i cili synon ta identifikojë, ruajë dhe mbrojë infrastrukturën e rëndësishme kombëtare dhe evropiane.

Autoritetet për zbatimin e ligjit demonstuan aftësi të mjaftueshme për t'i zbuluar dhe parandaluar disa komplete terroriste në Kosovë dhe jashtë saj. Drejtoria e PK-së kundër terrorizmit (DPKT), që është përgjegjëse për hetimet kundër terrorizmit, shtoi kapacitetet e veta hetimore duke rritur numrin e personelit dhe duke zhvilluar një njësi interneti kundër terrorizmit. Departamenti i Shtetit i mbështeti këto përpjekje përmes programit për ndihmë kundër terrorizmit.

Policia Kufitare e Kosovës rregullisht azhurnon listën e tyre të personave që dyshohen të kenë lidhje me terrorizëm ose aktivitete kriminale; ajo zhvilloi 33 aksione në vitin 2018. Kosova është e përkushtuar për zbatimin e plotë të Rezolutës 2396 të KSKB-ës.

Në qershor, DPKT-ja arrestoi pesë persona të dyshuar për planifikim të sulmeve terroriste në Kosovë dhe vende të Evropës Perëndimore. Një person tjetër, me origjinë kosovare, u arrestua në të njëjtën kohë në Gjermani, në bazë të një urdhërarresti ndërkombëtar të lëshuar nga Kosova, dhe më pas u ekstradua në Kosovë. Njësitë e PK-së, përgjegjëse për këto aksione, përfituan nga ndihma e rëndësishme e SHBA-së për ngritjen e kapaciteteve.

Në vitin 2018, gjykimet dhe hetimet vazhduan për 29 të dyshuar dhe nëntë raste. Imamët e Kosovës, të arrestuar më parë nën akuza të lidhura me terrorizëm, u liruan. Autoritetet e Kosovës arrestuan gjashtë individë të tjerë nën akuza të lidhura me terrorizmin dhe gjykatat lëshuan 20 aktgjykime dënuese për vepra penale të lidhura me terrorizmin. Autoritetet lëshuan katër aktakuza të reja nën akuzat për terrorizëm, ku përfshiheshin 11 persona.

Më 17 korrik, Gjykata Themelore e Prishtinës dënoi shtatë të pandehur dhe liroi një person nën akuzat për terrorizëm dhe armë në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në konfliktin sirian si anëtarë të ISIS-it dhe liroi një person. Të dënuarit morën dënime me burg prej 28 muaj deri në katër vjet.

Më 18 maj, Gjykata Themelore e Prishtinës dënoi tetë të pandehur për planifikim të një sulmi në Shqipëri kundër ekipit kombëtar të futbollit të Izraelit dhe caqeve të ndryshme në Kosovë në nëntor të vitit 2016. Dënimet silleshin prej 18 muaj deri në 10 vjet. Më 17 shtator, Gjykata e Apelit uli dënimin për secilin të pandehur.

Qeveria e Kosovës vazhdoi të demonstrojë vullnet politik për t'i adresuar kërcënimet në lidhje me terrorizmin përmes zbatimit të ligjit dhe sigurisë kufitare me ndihmë të rëndësishme nga SHBA-ja për ngritje të kapaciteteve. Ndonëse institucionet kombëtare vazhduan t'i forcojnë kapacitetet e tyre, burimet dhe përvoja e kufizuar vazhdojnë t'i pengojnë aftësinë e tyre për t'i trajtuar në mënyrë efektive çështjet e terrorizmit

Kundërvënia financimit të terrorizmit: Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës (NJIF) është anëtare e Grupit Egmont.

Luftimi i ekstremizmit të dhunshëm (CVE): Strategjia dhe plani për veprim CVE i Kosovës ofron një hartë rrugore pesëvjeçare për ta penguar kërcënimin në rritje të terrorizmit përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse të qeverisë, duke theksuar rolin kritik të palëve të interesuara lokale dhe të shoqërisë civile. Zbatimi ka qenë i pabarabartë nëpër ministritë e qeverisë dhe sfidat vazhdojnë për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe burimeve të pamjaftueshme. Në shtator,

Qeveria e Kosovës azhurnoi planin e saj të veprimit CVE, duke shtuar disa aktivitete të reja për riintegrim dhe rehabilitim.

Ministria e Drejtësisë e Kosovës vazhdoi zbatimin e një programi korigjues që synon forcimin e menaxhimit të terroristëve në burg, krijimin e kornizave për rehabilitim dhe riintegrim eventual të terroristëve të dënuar. Më 23 maj, Ministria e Punëve të Brendshme njoftoi për krijimin e një Sektori për Parandalim dhe Riintegrim. Qëllimi i këtij sektori është riintegrimi i individëve që kanë vuajtur dënimin në burg nën akuzat për terrorizëm, të kthyerit FTF (luftëtarë terroristë të huaj) dhe anëtarët e familjeve.

Strategjia CVE e Kosovës përfshin përgatitjen dhe mbështetjen e narracioneve për t'i delegjitimuar mesazhet e terroristëve. Në vitin 2018, Qeveria e Kosovës filloi të punojë me Hedayah-un dhe Ambasadën në Prishtinë për ta zhvilluar një strategji kombëtare të komunikimit për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Organizatrat kosovare vazhduan aktivitetet bashkëpunuese përmes Mekanizmit Mbështetës të Vendit nën GCERF, një fond global publiko-privat për t'i mbështetur përpjekjet lokale, bazike CVE në komunitetet në rrezik.

Ferizaji, Gjakova, Gjlani, Graçanica, Hani i Elezit, Kaçaniku, Mitrovica e jugut, Peja, Prishtina, Prizreni, Vitia, Vushtrria, dhe Zveçani janë anëtarë të Rrjetit Qytetet e Forta.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe rajonal: Qeveria e Kosovës ka punuar ngushtë me zyrtarët në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut për ta mbështetur ndërtimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimin kundër terrorizmit.

\\